

Shijimi i muzikës me Xperia/iPhone përmes një rrjeti me valë

Udhëzuesi i konfigurimit të shpejtë

Kjo fletëpalosje është një udhëzues konfigurimi për shijimin e muzikës nga Xperia (ose tabletë Xperia)/iPhone (ose iPad/iPod) me funksionin DLNA ose AirPlay përmes një rrjeti me valë.

Nevojitet një ruter LAN-i me valë (përfshirë pikë aksesi), për të përdorur rrjetin me valë.

Sistem audio për shtëpinë


4-464-271-11(1) (AL)
© 2013 Sony Corporation

CMT-SBT300W/SBT300WB

Referojuni udhëzimeve të përdorimit të këtij sistemi në rastet e mëposhtme.

- Për të luajtur muzikë me një telefon tjetër smartphone ose një kompjuter personal
- Kur aplikacioni "WALKMAN" nuk është i instaluar në Xperia
- Për të luajtur muzikë me BLUETOOTH

A ka buton WPS në ruterin tuaj LAN me valë?



* Xperia mund të mos ketë aplikacionin "WALKMAN". Në këtë rast, nuk mund të përdoret ky funksion. Ju mund të dëgjoni muzikë me disa modele të "WALKMAN", por ato mund të kërkojnë përdorim të ndryshëm. Për hollësi drejtijoni udhëzimeve të përdorimit të "WALKMAN".

A

Kryerja e një lidhjeje mes këtij sistemi dhe një ruteri LAN-i me valë me WPS


1 Kontrolloni që kabloja e rrjetit (LAN) të jetë e shkëputur nga sistemi, më pas lidhni kordonin e energjisë.



2 Shtypni butonin I/⏻ për të aktivizuar sistemin.


3 Treguesi i kuq STANDBY fiket, më pas fillon të pulsojë në dritaren e ekranit.

Mund të duhen disa minuta derisa të fillojë të pulsojë.



4 Shtypni butonin OPTIONS në telekomandë për të shfaqur "BT/NW STBY". Shtypni butonin ⬆/⬇ në telekomandë në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur "WPS" më pas shtypni butonin ⊕.

Nëse "WPS" nuk shfaqet, prisni rreth 2 minuta.



5 Kur shfaqet "OK" në ekran, shtypni butonin ⊕. "WPS" pulson.

6 Mbani shtypur për pak sekonda butonin WPS në ruterin me valë LAN.

Në disa ruterë, duhet të vazhdoni të shtypni butonin WPS.



7 "CONNECT" pulson pasi pulson "WPS" për disa dhjetëra sekonda në dritaren e ekranit të sistemit, pas të cilës ndizet sapo të kryhet lidhja.

Nëse nuk shfaqet brenda 5 minutave, konfigurimi mund të mos jetë kryer siç duhet. Në këtë rast, vazhdoni nga hapi 4 sërish. Nëse konfigurimi nuk është i suksesshëm pas kësaj, provoni lidhjen në anën tjetër të kësaj fletëpalosjeje.


Kur kryhet lidhja mes telefonit smartphone dhe ruterit LAN me valë, shkoni te pjesa më poshtë.

Për një përdorues të Xperia → **Luajtja e muzikës së ruajtur në Xperia**

Për një përdorues të iPhone → **Luajtja e muzikës së ruajtur në iPhone**

8 Sigurohuni që ruteri LAN me valë të jetë i ndezur. Kini gati SSID dhe çelësin e sigurisë.

Referojuni udhëzimeve të përdorimit të ruterit LAN me valë.



9 Kryeni një lidhje me valë mes telefonit tuaj smartphone dhe ruterit LAN me valë.


Për një përdorues të Xperia → **Lidhja e Xperia me LAN-in me valë**

Për një përdorues të iPhone → **Lidhja e iPhone me LAN-in me valë**

Lidhja e Xperia me LAN-in me valë




Luajtja e muzikës së ruajtur në Xperia



Lidhja e iPhone me LAN-in me valë



Luajtja e muzikës së ruajtur në iPhone




Kryerja e një lidhjeje mes këtij sistemi dhe një ruteri LAN-i me valë me aplikacionin për Xperia/iPhone "NS Setup"

Ju mund të kryeni një lidhje mes këtij sistemi dhe ruterit LAN me valë duke shkarkuar aplikacionin "NS Setup" në telefonin tuaj smartphone dhe duke e përdorur si më poshtë.


- 1** Kontrolloni që kabloja e rrjetit (LAN) të jetë e shkëputur nga sistemi, më pas lidhni kordonin e energjisë.



- 2** Sigurohuni që ruteri LAN me valë të jetë i ndezur. Kini gati SSID dhe çelësin e sigurisë. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të ruterit LAN me valë.



- 3** Shtypni butonin I/⏻ për të aktivizuar sistemin.



- 4** Treguesi i kuq STANDBY fiket, më pas fillon të pulsojë në dritaren e ekranit.

Mund të duhen disa minuta derisa të fillojë të pulsojë. Kryeni konfigurimin duke përdorur aplikacionin "NS Setup" për telefon smartphone.

Për një përdorues të Xperia → [Konfigurimi në Xperia](#)

Për një përdorues të iPhone → [Konfigurimi në iPhone](#)

Konfigurimi në Xperia

- 1** Shkarkoni aplikacionin falas "NS Setup" nga "Google Play".
- 2** Kryeni konfigurimin duke përdorur aplikacionin [NS Setup] për telefon smartphone.



Për shkarkim me 2D Code.




Trokitni [NS Setup] (Konfigurimi NS).



Trokitni [Let's get started] (Le të fillojmë).

Sistemi përgatitet për konfigurimin me valë. Prisi disa minuta derisa të shfaqet ekrani tjetër.



Zgjidhni SSID që kishit në hapin 2.



Vendosni çelësin e sigurisë që kishit në hapin 2.


Sistemi kontrollon nëse konfigurimi është kryer mirë apo jo. Prisi disa minuta derisa të shfaqet ekrani tjetër. Nëse shfaqet A te "Zgjidhja e problemeve" më poshtë, ndiqni udhëzimet e saj.



Trokitni [Play test sound] (Luaj sinjal testimi) për të konfirmuar veprimin e sistemit duke luajtur sinjalin e testimit.

Luajtja e muzikës së ruajtur në Xperia

- 1** Nisni (aplikacionin [WALKMAN]).
- 2** Trokitni ikonën dhe zgjidhni [SONY:CMT-SBT300W(B)XXXXXX].



Në ekranin e sistemit gjatë luajtjes shfaqet "NETWORK" (Rrjeti).

Konfigurimi në iPhone

- 1** Shkarkoni aplikacionin falas "NS Setup" nga "Apple Store".
- 2** Kryeni konfigurimin duke përdorur aplikacionin [NS Setup] për telefon smartphone.



Për shkarkim me 2D Code.




Trokitni [Settings] (Cilësimet).




Trokitni [Wi-Fi].



Trokitni [Sony_Wireless_...] (Konfigurimi i audios me valë Sony) për të shtuar një shenjë zgjedhjeje dhe më pas kthehuni në ekranin bazë.



Trokitni [NS Setup] (Konfigurimi NS).




Trokitni [Let's Get Started] (Le të fillojmë).


Sistemi përgatitet për konfigurimin me valë. Prisi disa minuta derisa të shfaqet ekrani tjetër. Nëse shfaqet C te "Zgjidhja e problemeve" më poshtë, ndiqni udhëzimet e saj.



Zgjidhni SSID që kishit në hapin 2.*



Vendosni çelësin e sigurisë që kishit në hapin 2.



Trokitni [Play Test Sound] (Luaj sinjal testimi) për të konfirmuar veprimin e sistemit duke luajtur sinjalin e testimit.

Luajtja e muzikës së ruajtur në iPhone

- 1** Nisni (aplikacionin [Music] (Muzikë)).
- 2** Trokitni ikonën dhe zgjidhni [SONY:CMT-SBT300W(B)XXXXXX].



Në ekranin e sistemit gjatë luajtjes shfaqet "AirPlay".

Zgjidhja e problemeve

Ekranet më poshtë mund të shfaqen gjatë konfigurimit. Në këto raste, ndiqni udhëzimet që jepen.



Nëse shfaqet A ose B, rivendosni sistemin duke ndjekur hapat te "Për të rivendosur sistemin" në të djathtë. Më pas kryeni veprimet e konfigurimit sërish nga hapi i parë i @ në "Konfigurimi në Xperia" ose "Konfigurimi në iPhone".



Nëse shfaqet C kryeni veprimet e konfigurimit sërish nga hapi i parë i @ te "Konfigurimi në iPhone".



Nëse shfaqet D veproni duke ndjekur udhëzimet në ekran.

Nëse konfigurimi nuk është i suksesshëm pas kësaj ose shfaqet "NO CONNECT" (Nuk ka lidhje) në dritaren e ekranit të sistemit, rivendosni sistemin duke ndjekur hapat te "Për të rivendosur sistemin" djathtas.

Për të rivendosur sistemin

Rivendoseni sistemin si më poshtë.

Gjithashtu, nëse "Sony_Wireless_Audio_Setup" nuk shfaqet gjatë konfigurimit të iPhone, rivendoseni sistemin.

- 1** Shkëputeni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë dhe sigurohuni që treguesi STANDBY nuk ndizet. Më pas rilidhni kordonin e rrymës dhe ndizni sistemin.
- 2** Mbani shtypur butonat (ndal) dhe I/⏻ të sistemit derisa të shfaqet "ALL RESET".

